

**GJYKATA E QARKUT  
E GJILANIT  
31 tetor 2011**

**AC.nr.158/2011**

**GJYKATA E QARKUT E GJILANIT**, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja civile e EULEX-it Rositza BUZOVA, si kryetare e trupit gjykues, gjyqtarit vendor Muhamet REXHA dhe gjyqtarit vendor Abdullah AHMETI, si anëtarë të trupit gjykues,

*Në lëndën civile të paditësit SHABAN PAJAZITI nga PRISHTINA, të përfaqësuar nga avokati XHAFER MALIQI nga PRISHTINA, të paraqitur kundër të paditurës Ndërmarrjes Private "PROGRESS" Kompani me Përgjegjësi të Kufizuara (KPK) – fshati SHILLOVË, komuna e GJILANIT e përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues HEVZI XHELILI nga fshati PËRLEPNICË, komuna e GJILANIT, pas padisë për hjekje dorë nga kontrata për shitblerje të pronës së paluajtshme për shkak të mos-përmbushjes sipas nenit 124 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ № 29/78, me përmirësime në № 39/85, 45/89, 57/89 dhe në Gazetën Zyrtare të RFJ № 31/93) (më tej "LCT") me vlerë të kontestit 3 000 Euro,*

*Pas pranimit të ankesës së "PROGRESS" KPK kundër aktgjykimit C.nr.72/10 të Gjykatës Komunale të KAMENICËS të datës 22 mars 2011 për aprovimin e kësaj padie dhe pas gjykimit të saj në procedurën e shkallës së dytë të rregulluar me nenet 176 – 205 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 38/2008) (më tej "LPK"),*

*Pas këshillimit dhe votimit rreth ankesës më lart në séancën e trupit gjykues sipas nenit 190, paragrafi 1, hipoteza e parë e LPK-së e mbajtur me 31 tetor 2011,*

*Për këto arsye në pajtim me nenin 195, paragrafi 1, pika d) në lidhje me nenin 200 LKP lëshon të mëposhtmin*

## **AKTGJYKIM**

**REFUZOHET** ankesa e NDËRMARRJES PRIVATE "PROGRESS" KOMPANI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA - fshati SHILLOVË, komuna e GJILANIT, e përfaqësuar nga Drejtori HEVZI XHELILI nga fshati PËRLEPNICË, komuna e GJILANIT si e pabazuar dhe **KONFIRMOHET** aktgjykimi C.nr.72/2010 i Gjykatës Komunale të KAMENICËS të datës 22 mars 2011.

## **ARSYETIM**

### **I. Historiati procedural**

1. Me aktgjykimin C.nr.72/10 të Gjykatës Komunale të KAMENICËS të datës 22 mars 2011 ishte aprovuar si e bazuar kërkesë padia e paditësit SHABAN PAJAZITI nga PRISHTINA, të përfaqësuar nga avokati XHAFER MALIQI nga

PRISHTINA, të paraqitur kundër të paditurës Ndërmarrjes Private “PROGRESS” Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara (SHPK) – fshati SHILLOVË, komuna e GJILANIT e përfaqësuar nga Drejtori Menaxhues HEVZI XHELILI nga fshati PËRLEPNICË, komuna e GJILANIT dhe ishte hjekur dorë nga kontrata për shitberje të pronës së paluajtshme ne mes të palëve ndërgjyqëse , të vërtetuar nga Gjykata Komunale e KAMENICËS si Vr.nr.395/09 me 16 mars 2009 për shkak të mospërmbushjes së obligimeve nga blerësi për ngastrat kadastrale nr.1684/1, 1684/2, 1713, 1714/1, 1715, 2890 dhe ndërtesat në ngastrat kadastrale nr.2890-00001, 00002, 00003, 00004, 00005, të regjistruara në Certifikatën nr.UL-71107033-00417, ZK KËRMJAN I POSHTËM, komuna e KAMENICËS; Drejtorati për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi ishte i obliguar të çregjistrojë këto prona të paluajtshme nga emri i të paditurit “PROGRESS” SHPK dhe të regjistrojë paditësin SHABAN PAJAZITIN si mbajtës i të drejtës së shfrytëzimit të tyre për 99 vite; i padituri ishte i obliguar që t’ia kompensojë shpenzimet procedurale në shumën prej 1 280.80 Eurove brenda 15 ditëve pas hyrjes në fuqi të aktgjykimit nën kërcenim të ekzekutimit.

2. Me 15 prill 2011, e paditura Ndërmarrja Private Enterprise “PROGRESS” SHPK – fshati SHILLOVË, komuna e GJILANIT, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor drejtorit HEVZI XHELILI, paraqiti një ankesë kundër aktgjykimit C.nr.72/2010 të Gjykatës Komunale të KAMENICËS, me 22 mars 2011 duke e kundërshtuar atë për *shkelje substanciale të dispozitave të procedurës kontestimore* sipas nenit 182 LPK, *vërtetim jo i plotë dhe i gabueshëm i gjendjes faktike* sipas nenit 183 LPK dhe *zbatim i gabueshëm i të drejtës materiale* sipas nenit 184 LPK. Kërkesa e paditësit është që gjykata e shkallës së dytë të anulojë këtë aktgjykim me kthimin e lëndës në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

3. Sipas nenit 187, paragrafi 1 LPK kopjet e ankesës iu kishin dërguar Avokatit XHAFER MALIQI nga PRISHTINA me 21 prill 2011 dhe tek SHABAN PAJAZITI personalisht me 23 prill 2011 për përgjigje brenda 7 ditëve. Pasi që përgjigjja nuk ishte paraqitur deri në skadimin e periudhës së paraparë me ligj me 28 prill 2011, sipas nenit 188, paragrafi 1 LPK me 3 maj 2011 ankesa me lëndën ishin dërguar ne Gjykatën e Qarkut të GJILANIT dhe ishte regjistruar atje me 11 maj 2011.

## II. Kompetenca e trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT

4. AC.nr.158/2011 e Gjykatës së Qarkut të GJILANIT ishte përzgjedhur bazuar në nenin 5, paragrafin 1, pika c) e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (“Ligji Nr.03/L-053 mbi Kompetencat”) nëpërmjet aktvendimit të lëshuar me 18 korrik 2011 nga një gjyqtar i EULEX-it i cili vepron si i Emëruari i Kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it bazuar në vendimin ref.nr.JC/EJU/OPEJ/2496/ff/11, të datës 5 korrik 2011. Ky i fundit pas mbajtjes së procedurës së marrjes sipas nenit 5, paragrafi 7, fjalia e parë e Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në KOSOVË në lëndët civile, lëshoi aktvendim me 3 gusht 2011 sipas

nenit 5, paragrafit 7, fjalia e dytë e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat për caktimin e lëndës civile të shkallës së dytë trupit gjykues të përzier të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT sipas nenit 5, paragrafët 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat me kryetar të trupit gjykues nga EULEX. Dy gjyqtarët vendorë – anëtarët e trupit gjykues, pas derogimit sipas nenit 5, paragrafi 5 i Ligjit Nr.03/L-053 mbi Kompetencat, ishte caktuar me vendimin Agj.nr.162/11 të Kryetarit të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, me 4 gusht 2011.

5. Duke qenë i përbërë në mënyrë ligjore në përputhje me kërkesat specifike të nenit 5, paragrafët 1, 2, 4, 5 dhe 7 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, ky trup gjykues i Gjykatës së Qarkut të GJILANIT është fuqizuar të gjykojë AC.nr.158/11 bazuar në kompetencën funksionale të gjykatës së shkallës së dytë të paraparë me dispozitat e përgjithshme të nenit 15, paragrafi 2 dhe neni 176, paragrafi 3 LPK.

### III. Pranueshmëria e ankesës dhe procedurat e shkallës së dytë

6. Nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për gjykimin e ankesës. *Së pari*, parashtrimi i saj nuk është i ndaluar por në mënyrë eksplicite parashihet me nenin 176, paragrafi 1, fjalia e parë e LPK-së pasi që vendimi gjyqësor i ankimuar është aktgjykim i shkallës së parë në bazë të ankesës. *Së dyti*, ankesa nuk është e vonuar sipas kërkesave të nenit 186, paragrafi 2 LPK. Aktgjykimi C.nr.72/2010 i Gjykatës Komunale të KAMENICËS, i datës 22 mars 2011 iu kishte dorëzuar “PROGRESS” SHPK nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor HEVZI XHELILIT me 7 prill 2011. Ankesa e saj ishte paraqitur me 15 prill 2011, para skadimit të periudhës 15 ditore të paraparë me nenin 176, paragrafi 1, fjalia e parë LPK me 22 prill 2011. *Së treti*, ankesa nuk është e papranueshme sipas nenit 186, paragrafi 3 LPK e paraqitur nga i padituri në procedurat e shkallës së parë nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor. Si palë ndërgjyqëse, paditësi ka të drejtën procedurale dhe interesin ligjor ta dorëzojë atë dhe nuk ka hjekur dorë apo tërhequr atë. *Së katërti*, ankesa ka përmbajtjen e detyrueshme sipas nenit 178, pikat a) – d) LPK dhe është e plotë sipas nenit 179, paragrafi 1 LPK. Shkurt, nuk ka baza ligjore që përjashton pranueshmërinë e ankesës apo procedurës së shkallës së dytë sipas nenit 176 – 205 LPK të inicuar nga ajo.

### IV. Përmbledhje e procedurave të shkallës së parë

7. Me 22 prill 2010, SHABAN PAJAZITI nga PRISHTINA paraqiti një padi kundër Ndërmarrjes Private “PROGRESS” SHPK–fshati SHILLOVË, komuna e GJILANIT. Pretendimet ankimore në padi ishin se duke qenë posedues ligjor dhe faktik i ngastrave kadastrale nr.1684/1, 1684/2, 1713, 1714/1, 1715, dhe 2890, si dhe ndërtesave në ngastrat kadastrale nr.2890/1, 2890/2, 2890/3, 2890/4 dhe 2890/5, të regjistruara në Certifikatë nr.UL-71107033-00417 (Lista Poseduese nr.417) ZK KËRMJAN I POSHTËM, komuna e KAMENICËS, paditësi i shiti të paditurit të gjitha pronat e paluajtshme me ndërtesat ekzistuese bazuar në kontratën për shitblerje Vr.nr.395/09, të vërtetuar nga Gjykata Komunale e KAMENICËS me 16 mars 2009 me shumën 600 000 Euro. Ata ishin marrur vesh që kjo shumë të paguhej në pjesë – 400 000 Euro një muaj nga data e nënshkrimit të kontratës dhe shuma e mbetur prej

200 000 Eurove në tri rata në dy vitet vijuese. I padituri nuk i ka përmbushur këto obligime –bazuar në raportet bankare të bashkangjitura në padi deri në atë datë ai nuk ka transferuar në llogarinë e paditësit asnjë shumë si pagesë të çmimit. Kërkesë padia e përmirësuar përfundimisht, ishte që të hiqet dorë sipas nenit 124 LMD për shkak të mos-përmbushjes dhe që të obligojë Drejtoratin për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi që të bëj ndryshimet përkatëse kadastrale.

8. Kjo padi ishte regjistruar për gjykim si C.nr.30/2010 në Gjykatën Komunale të KAMENICËS. Me aktvendimin e lëshuar me 18 qershor 2010 ajo shpalli jokompetencën territoriale për të vendosur sipas nenit 15, nenit 22, paragrafit 3, nenit 37, paragrafit 1, nenit 38, paragrafët 1 - 2 dhe neni 39, paragrafi 2 LPK për shkak të lokacionit të zyrës kryesore të personit ligjor – të paditurit dhe vendbanimit të përhershëm i përfaqësuesit të saj ligjor në territorin e Gjykatës Komunale të GJILANIT. Pasi që ky aktvendim u bë i plotfuqishëm, me 14 korrik 2010 lënda u referua në Gjykatën Komunale të GJILANIT dhe u regjistrua atje si C.nr.374/2010. Kjo e fundit me 22 korrik 2010 duke e arsyetuar veten me ekzistencën e kompetencës së veçantë territoriale të miratuar për konteste të ngritura sipas kontratës në pajtim me nenin 53 dhe nenin 66 LPK për Gjykatën Komunale të KAMENICËS inicoi një konflikt për kompetencë lidhur me këtë lëndë sipas nenit 24, paragrafi 1 dhe nenit 25, paragrafi 1 LPK. Ajo ishte zgjidhur me aktvendimin CN.nr.11/10 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 27 korrik 2010 e cila e shpalli Gjykatën Komunale të KAMENICËS me kompetencë territoriale dhe e referoi lëndën tek ajo për gjykim të mëtutjeshëm. Me 28 korrik 2010 lënda u kthye në Gjykatën Komunale të KAMENICËS dhe iu dha numër i ri i lëndës – C.nr.72/2010.

9. Me aktvendimin C.nr.72/2010 të Gjykatës Komunale të KAMENICËS, të datës 10 gusht 2010 propozimi për masa të përkohshme të përfshirë në padi ishte aprovuar dhe i padituri ishte ndaluar në pajtim me nenin 300, paragrafi 1, pika a) dhe neni 301, paragrafi 1, pikat a) – d) LPK që tá tjetërsojë, lëshoj me qira, ta hipotekoj dhe të bëj çfarëdo transaksioni tjetër formal ligjor apo të ushtrojë çfarëdo të drejte tjetër lidhur me pronën e patundshme të kontestuar deri në përfundimin e padisë.

10. Me 19 gusht 2010, i padituri paraqiti një kundërshtim sipas nenit 306, paragrafi 2 LPK duke kërkuar që masa e përkohshme më lart të anulohet dhe procedura ekzekutive bazuar në të, të ndërpritet. Kundërshtimi ishte paraqitur nga avokati MUSTAFË MUSA nga GJILANI, si përfaqësues i të paditurit i autorizuar me autorizim , me 12 gusht 2010, me fushëveprim të përgjithshëm për të gjitha veprimet procedurale në C.nr.72/2010 të Gjykatës Komunale të KAMENICËS.

11. Pas séancës dëgjimore sipas nenit 306, paragrafi 2 LPK, aktvendimi C.nr.72/10 i Gjykatës Komunale të KAMENICËS, të datës 26 gusht 2010 ishte lëshuar duke e zëvendësuar pa asnjë ndryshim atë të masës së përkohshme , të datës 10 gusht 2010 që urdhëron masën e sigurisë deri në përfundimin e kontestit sipas nenit 306, paragrafi 3 LPK.

12. Me aktvendimin AC.nr.333/2010 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 2 nëntor 2010 ishte refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurit kundër aktvendimit C.nr.72/2010 të Gjykatës Komunale të KAMENICËS, të datës 26 gusht 2010 në pajtim me nenin 209 LPK.

13. Asnjë séancë paraprake nuk është mbajtur në procedurat e shkallës së parë bazuar në përjashtimin e paraparë me nenin 401 LPK. Në séancën e parë gjyqësore si séancë kryesore të caktuar për 22 shkurt 2011 të pranishëm ishin vetëm përfaqësuesi i tij i autorizuar Avokati XHAFER MALIQI nga PRISHTINA, kurse përfaqësuesi ligjor i të paditurit HEVZI XHELILI edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt nuk u shfaq në séancë. Me parashtresën e paraqitur në lëndë me 16 shkurt 2011 ai arsyetoi mungesën e tij me një udhëtim të rëndësishëm afarist në Austri nga 20 deri me 26 shkurt 2011 dhe kërkoi shtyrje. Ajo ishte lejuar nga Gjykata Komunale e KAMENICËS me arsyetimin se përfaqësuesve ligjorë dhe të autorizuar duhet t'iu ipet mundësia që të marrin pjesë në séancën kryesore të caktuar për 22 mars 2011 me ftesën e tyre të urdhëruar sipas nenit 422 të LPK-së.

14. Thirrja për séancën kryesore me 22 mars 2011 iu kishte dorëzuar në mënyrë të rregullt avokatit MUSTAFË MUSA, përfaqësuesit të autorizuar të të paditurit, me 25 shkurt 2011 në përputhje me nenin 107, paragrafi 1, nenin 110, paragrafi 1, fjalia e parë LPK, të vërtetuar me nënshkrimin e tij dhe datën e pranimit të shënuar me dorëshkrimin e tij në dëftesë në pajtim me nenin 121, paragrafi 1 LPK.

15. Avokati MUSTAFË MUSA paraqiti parashtresë me shkrim me 28 shkurt 2011 në lëndën për *revokimin e autorizimit të tij si përfaqësues i të paditurit në C.nr.72/10 të Gjykatës Komunale të KAMENICËS*. Ai theksoi se të gjitha njoftimet e *ardhshme* duhet ti dërgohen përfaqësuesit ligjor të të paditurit, si dhe që *ekziston kohë e mjaftueshme për atë që të përgatitet për séancën e caktuar për 22 mars 2010 në mënyrë që të mos shtyhet*.

16. Me 21 mars 2011 në emër të Ndërmarrjes Private "PROGRESS" SHPK përfaqësuesi ligjor HEVZI XHELILI paraqiti një parashtresë me shkrim në lëndë. Gjatë pranimit të dëftesës së thirrjes adresuar tek ai për séancën kryesore të datës 22 mars 2011 dhe duke bashkangjitur kopjen e saj, ai kërkoi që kjo séance të shtyhet deri në caktimin e avokatit të ri i cili do ta përfaqësonte atë në lëndë.

17. Në seancën kryesore me 22 mars 2011 paditësi u paraqit personalisht me përfaqësuesin e tij të autorizuar Avokatin XHAFER MALIQI, kurse për të paditurin nuk ka qenë askush i pranishëm. Në lidhje me *mungesën e tij* në pajtim me nenin 432, paragrafi 2 LPK, Gjykata Komunale e KAMENICËS konstatoi se kjo palë ka qenë e njoftuar në mënyrë të rregullt siç dëshmohet me kopjen e ftesës bashkangjitur në parashtresën e saj të datës 21 mars 2011, si dhe nuk ka pasur asnjë arsye për të arsyetuar atë. Në lidhje me përfaqësimin e të paditurit u njoftuar se që nga 28 shkurti 2011, data e revokimit të autorizimit të avokatit MUSTAFË MUSA, deri me 22 mars 2011, data e séancës kryesore, kjo palë ka qenë në gjendje të zgjedhë një përfaqësues të ri të autorizuar. Kështu që, është përfunduar se me kërkesën për shtyerje të séancës

kryesore me 22 mars 2011 i padituri u mundua që të shtyjë procedurat dhe ishte vendosur që kjo seancë të mbahet në mungesë të kësaj pale në pajtim me nenin 423, paragrafi 4 LPK. Në lidhje me këtë, deklarata e përfaqësuesit të paditësit ishte paraqitur – neni 425, paragrafi 1, pika a) LPK, dëshmitë dokumentare ishin mbledhur – neni 425, paragrafi 1, pika c) LPK, dëshmitari i propozuar nga paditësi ishte marrur në pyetje – neni 425, paragrafi 1, pika d) LPK, dhe fjala përfundimtare e përfaqësuesit të saj ishte dëgjuar - neni 425, paragrafi 1, pika f) LPK. Kështu që seanca kryesore ishte kompletuar në pajtim me nenin 436, paragrafi 1 LPK.

18. Me aktgjykimin C.nr.72/2010 të GJK të KAMENICËS, të datës 22 mars 2011, kërkesëpadia ishte aprovuar si e bazuar sipas nenit 124 LMD dhe i padituri ishte obligojë të kompensojë shpenzimet procedurale të paditësit sipas nenit 452, paragrafi 1 LPK. Kopjet e saj ishin dorëzuar në mënyrë të rregullt tek përfaqësuesi i paditësit me 4 prill 2011, paditësit personalisht me 7 prill 2011 dhe përfaqësuesit ligjor të të paditurit me 7 prill 2011.

**V. Ekzaminimi ankimor i gjykatës së shkallës së dytë sipas nenit 194 LPK**

***Shkelje substanciale e dispozitave të procedurës kontestimore - neni 182 LPK***

19. Baza e parë për ankimimin e aktgjyimit C.nr.72/10 të Gjykatës Komunale të KAMENICËS, të datës 22 mars 2011 është sipas nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK për shkelje substanciale të dispozitave të procedurës kontestimore sipas nenit 182, paragrafi 2, pika i) LPK për shkak të mundësisë së mohuar në mënyrë të paligjshme të të paditurit për të ndjekur seancën kryesore me 22 mars 2011.

20. Parakushtet për të mbajtur seancën kryesore në procedurat e shkallës së parë janë 1) ftesa në mënyrë të rregullt e të gjitha palëve – neni 423, paragrafi 2 *in fine* LPK; 2) prezenca e paditësit – neni 423, paragrafi 3 LPK; 3) mungesa e pengesave procedurale për të vazhduar me lëndën – neni 424, paragrafi 1 LPK; dhe 4) mungesa e bazave ligjore për shtyrje – neni 437, paragrafi 1 dhe neni 438, paragrafi 1 LPK. Të gjitha këto kanë ekzistuar gjatë mbajtjes së seancës kryesore në C.nr.72/2010 të Gjykatës Komunale të KAMENICËS me 22 mars 2011.

21. Paditësi dhe përfaqësuesi i tij i autorizuar Avokati XHAFER MALIQI, duke qenë të pranishëm në seancën kryesore me 22 shkurt 2011, ishin informuar për aktvendimin e lëshuar në të njëjtën seancë për shtyrje të gjykimit me 22 mars 2011 në ora 10.00 . Kështu që pa thirrje shtesë me shkrim , *paditësi ishte njoftuar në mënyrë të rregullt për seancën kryesore me 22 mars 2011* në pajtim me nenin 421, paragrafi 1 LPK.

22. Pasi që askush nuk mori pjesë në seancën kryesore me 22 shkurt 2011 për të paditurin , gjatë shtyrjes së seancës së njëjtë për 22 mars 2011 në ora 10:00, Gjykata Komunale e KAMENICËS duke vepruar në pajtim me nenin 422, paragrafi 1 LPK urdhëroi thirrjen me shkrim të përfaqësuesit të saj ligjor – HEVZI XHELILIT, Drejtorit të “PROGRESS’ SHPK, dhe përfaqësuesit të saj të autorizuar avokatit MUSTAFË MUSA. Dëftesa e thirrjes së parë adresuar tek “PROGRESS’ SHPK

*nëpërmjet HEVZI XHELILIT* ishte pranuar ne parashtrësën e tij të paraqitur në lëndë me 21 mars 2011 dhe e dëshmuar me kopje të bashkangjitur të thirrjes të dërguar me 22 shkurt 2011 për seancën e caktuar për 22 mars 2011 – në ora 10.00. Kjo thirrje përputhet me kërkesat e nenit 75, nenit 77, paragrafi 1, nenit 107, paragrafi 1 dhe nenit 110, paragrafi 1, fjalia e parë LPK. Në lidhje me *thirrjen e dytë* dërguar tek “PROGRESS” SHPK *nëpërmjet Avokatit MUSTAFË MUSA*, iu kishte dorëzuar atij me postë me 25 shkurt 2011 në pajtim me nenin 86, paragrafi 2, neni 91, paragrafi 1, pika a), neni 103, paragrafi 1, neni 107, paragrafi 1 dhe neni 110, paragrafi 1, fjalia e parë LPK. Ky dërgim është i dëshmuar me dëftesën e bashkangjitur në lëndë, me datë dhe e nënshkruar nga ky marrës siç kërkohet me nenin 121, paragrafi 1 LPK. Me 25 shkurt 2011, data e dorëzimit të kësaj thirrje statusi i avokatit MUSTAFË MUSA ishte i një përfaqësuesi të autorizuar të “PROGRESS” SHPK sipas nenit 86, paragrafi 1 LPK. Pasi që fushëveprimi i autorizimit të tij të përcaktuar me autorizim të datës 22 janar 2011, ishte i përgjithshëm për të gjitha veprimet sipas nenit 90, paragrafi 1, pika a) LPK, ai *përfshiu përfaqësimin e të paditurit sipas nenit 107, paragrafi 1 LPK në shërbimin e përmendur të ftesës për seancën kryesore me 22 mars 2011 të hyrë në fuqi me 25 shkurt 2011*. Revokimi i autorizimit të avokatit MUSTAFË MUSA si përfaqësues i të paditurit ishte komunikuar në Gjykatën Komunale të KAMENICËS me parashtrësën me shkrim të paraqitur me 28 shkurt 2011 në ora 8.57, zyrtarisht e vërtetuar me vulën e gjykatës të vendosur në të. Kështu që sipas nenit 94, paragrafi 2 LPK *revokimi ka prodhuar efekt juridik në procedura që nga 28 shkurti 2011, vetëm ex nunc*. Ajo nuk ka shfuqizuar në mënyrë retroaktive asnjë nga veprimet tanimë të ndërmarra nga avokati i tij në këtë lëndë para 28 shkurtit 2011, kur revokimi i autorizimit të dhënë nga i padituri ishte paraqitur në lëndë në përputhje me nenin 94, paragrafi 2 LPK. Për shkak të mos-retroaktivitetit të këtij revokimi sipas nenit 94, paragrafi 1 LPK, në fuqi që nga 28 shkurti 2011, ofrimi i mëhershëm i ftesës së pranuar nga avokati MUSTAFË MUSA me 25 shkurt 2011 në emër të “PROGRESS” SHPK për seancën kryesore me 22 mars 2011, ka mbetur si e dorëzuar në mënyrë të rregullt me efekt ligjor si lajmërim i duhur të kësaj pale ndërgjyqëse për këtë seancë kryesore. Ajo ishte ofruar me 25 shkurt 2011, më shume 7 ditë para seancës kryesore, siç parashihet me nenin 402, paragrafi 2 LPK. Apo, *paditësi* ishte informuar për datën dhe kohën e seancës kryesore me 22 mars 2011 në seancën e mëparshme të shtyrë me 22 shkurt 2011 në përputhje me nenin 421, paragrafi 1 LPK, gjersa i *padituri* ishte ftuar me shkrim në përputhje me nenin 422, paragrafi 1 LPK. Kështu që, të dy palët ndërgjyqëse ishin njoftuar dhe ky kusht i parë për mbajtjen e seancës kryesore i paraparë me nenin 423, paragrafi 2 LPK ishte përmbushur.

**23.** Siç shënohet zyrtarisht në procesverbalin e seancës kryesore me 22 mars 2011, *paditësi ishte i pranishëm në këtë seancë*. Kështu që, pasojat ligjore të mungesës së tij sipas nenit 423, paragrafi 3 LPK ishte i pa-aplikueshëm; padia nuk mund të konsiderohet e tërhequr dhe seanca kryesore me 22 mars 2011 nuk mund të anulohet mbi këtë bazë. Dështimi i të paditurit të thirrur në mënyrë të rregullt për t’ paraqitur në seancë nuk mund të përjashtojë rregullsinë e saj pasi që në kjo fjali neni 423,

paragrafi 4 LPK në mënyrë eksplicite parasheh *mbajtjen e seancës në mungesë të të paditurit*. Asnjë kundërshtim me asnjë nga dispozitat e procedurës kontestimore, nuk mundet të identifikohet në këtë çështje.

**24.** Asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me lëndën nuk mundet të përcaktohet nga gjykata *ex officio* apo mbi kundërshtimin e palës sipas nenit 424, paragrafi 1 LPK. Kështu që seanca kryesore me 22 mars 2011 nuk ishte e papranueshme për shkak të mos-pranueshmërisë së procedurave të shkallës së parë në C.nr.72/2010 të Gjykatës Komunale të KAMENICËS në përgjithësi sipas neneve 391 – 392 LPK.

**25.** *Asnjë bazë ligjore nuk ka ekzistuar për shtyrjen e seancës kryesore me 22 mars 2011. Së pari*, pasi që kushtet ligjore për inicimin e saj sipas nenit 424 LPK ishin përmbushur dhe nuk ka pasur asnjë dëshmi të pambledhur për tu paraqitur në këtë seancë, e mëvonshme nuk ka mundur të ri-caktohet *ex officio* bazuar në nenin 437, paragrafi 1 LPK. *Së dyti*, propozimi i të paditurit për shtyrjen e seancës kryesore me 22 mars 2011 i bërë me parashtresën e datës 21 mars 2011, nuk kishte të bënte me mbledhjen e çfarëdo pjesë të dëshmisë në lëndë, që nuk ka mundur të merret nga kjo palë. Kështu që Gjykata Komunale e KAMENICËS nuk ka mundur të shtyj seancën kryesore me 22 mars 2011 në pajtim me nenin 438, paragrafi 1, pika a) LPK pasi që kushtet e kërkuara nga dispozita e njëjtë për shtyrjen e tillë nuk kanë ekzistuar në këtë seancë gjyqësore. *Së treti*, neni 438, paragrafi 1, pika a) LPK gjithashtu ka qenë jo e aplikueshme – palët nuk kanë propozuar që seanca kryesore e datës 22 mars 2011 të shtyhet në mënyrë që të arrihet marrëveshje gjyqësore miqësore apo marrëveshje jashtë-gjyqësore. *Së katërti*, pasi që bazat ligjore për shtyrjen e seancës kryesore në procedurat e shkallës së parë janë të numëruara në *mënyrë eksplicite* dhe *në mënyrë shteruese* në nenin 437, paragrafi 1 dhe neni 438, paragrafi 1, pikat a)–b) LPK, *per argumentum ad contrario* seanca e 22 marsit 2011 nuk ka mundur të shtyhet në mënyrë të ligjshme për asnjë arsye tjetër, duke përfshirë edhe ato të shënuara në ankesë.

**26.** Të pabazuara janë të gjitha argumentet e paditësit lidhur me shkeljet procedurale të supozuara sipas nenit 182, paragrafi 2, pika i) LPK. *Së pari*, mungesa e të paditurit në seancën kryesore me 22 mars 2011 nuk përbën shkelje procedurale *per se* – mbajtja e saj në mungesë të kësaj pale është në mënyrë eksplicite e lejuar me nenin 423, paragrafi 4 LPK. *Së dyti*, pasi që nuk ka pasur asnjë arsye për shtyrje apo vazhdim të seancës kryesore të atyre të parapara në Kapitullin XXIV, paragrafi 2) LPK, dhe të gjitha fazat e seancës kryesore të listuara në nenin 425, paragrafi 1 LPK ishin përfunduar me 22 mars 2011, Gjykata Komunale e KAMENICËS ishte e obliguar me nenin 436, paragrafi 1 LPK që të deklarojë atë të mbyllur në fund të së njëjtës seancë. Ky përfundim i gjykimit të shkallës së parë në mungesë të të paditurit përputhet me dispozitat e procedurës kontestimore dhe *vice versa* nuk i ka shkelur ato në asnjë mënyrë. *Së treti*, Avokati MUSTAFË MUSA revokoi autorizimin e dhënë nga Ndërmarrja Private “PROGRESS” SHPK me parashtresën e tij të paraqitur në lëndë me 28 shkurt 2011, siç dëshmohet zyrtarisht me vulën gjyqësore të përdorur për

regjistrimin e dokumenteve hyrëse, *jo me 20 mars 2011*, siç supozohet gabimisht në ankesë. Pasi që revokimi i autorizimit të avokatit MUSTAFË MUSA, i datës 12 gusht 2010 ka prodhuar efektin juridik në seancë me 28 shkurt 2011, kur ishte komunikuar në Gjykatën Komunale të KAMENICËS me shkrim në pajtim me nenin 94, paragrafi 1, fjalia e dytë në lidhje me nenin 94, paragrafin 2, fjalia e dytë LPK, parashtresa e të paditurit e datës 21 mars 2011, në kundërshtim me thëniet në ankesë *nuk mundet të jetë tërheqje e të njëjtit autorizim nga kjo palë sipas nenit 94, paragrafi 1, fjalia e parë LPK – duke qenë e revokuar në mënyrë të njëanshme nga përfaqësuesi, tanimë ishte anuluar dhe nuk ka mundur më pas të tërhiqet nga pala. Më tej, parashtresa e njëjtë e të paditurit , e datës 21 mars 2011 nuk mund të jetë komunikim me shkrim të revokimit të autorizimit të avokatit MUSTAFË MUSA sipas nenit 94, paragrafi 2 LPK në prani të një komunikimi të mëhershëm me shkrim të bërë nga vet avokati MUSTAFË MUSA me parashtresën e tij me datë 28 shkurt 2011. Kështu që me parashtresën e tij të datës 21 mars 2011 autorizimi i tij as nuk është tërhequr nga i padituri e as nuk është komunikuar nga e njëjta palë në gjykatë, pasi që tanimë kjo ishte revokuar nga përfaqësuesi i tij. Avokati MUSTAFË MUSA anuloi autorizimin e tij sipas nenit 94, paragrafët 1 dhe 2 LPK, që hynë në fuqi nga 28 shkurti 2011, dhe sipas nenit 94, paragrafi 3 LPK duhet të ndërmerret veprime procedurale në emër të të paditurit për 15 ditë të tjera pas anulimit deri me 15 mars 2011, në mënyrë që ti shmanget çfarëdo dëmi që mund ti shkaktohet palës gjatë kësaj periudhe. Ratio është që të neutralizojë rreziqet procedurale që munden të ngritën për këtë palë pas revokimit të autorizimit nga përfaqësuesi i tij i mëparshëm dhe që ti ipet mundësia të organizojë në mënyrë adekuate pjesëmarrjen e tij të ardhshme në seanca ose personalisht sipas nenit 74, paragrafi 1 LPK, ose nëpërmjet përfaqësuesit të ri të autorizuar në pajtim me nenin 85, paragrafi 1 LPK. Me këtë përfaqësim të përkohshëm të vendosur *ex lege* për një periudhë kohore prej 15 ditëve pasi që autorizimi është revokuar, të drejtat procedurale të palëve ndërgjyqëse përkatëse janë të siguruara me nenin 94, paragrafi 4 LPK në mënyrë që të shmangen dëmet që mund të shkaktohen gjatë kësaj periudhe. Kjo është mënyra si revokimi i autorizimit sipas nenit 94, paragrafi 1 LPK *nuk parashihet në mënyrë normative si një bazë as për suspendim e as për shtyrje të seancave sipas nenit 437, paragrafi 1 apo nenit 438, paragrafi 1 LPK*. Avokati MUSTAFË MUSA revokoi autorizimin e tij me 28 shkurt 2011, periudhë 15 ditore sipas nenit 94, paragrafi 4 LPK në të cilin ai ka për detyrë të vazhdojë të përfaqësojë të paditurin që skadon me 15 mars 2011, gjersa seanca kryesore ishte mbajtur me 22 mars 2011. Që nga ajo datë periudha kohore sipas nenit 94, paragrafi 4 LPK tani kishte skaduar, përfaqësimi i Avokatit MUSTAFË MUSA për të paditurin ishte shfuqizuar *plotësisht* sipas nenit 94, paragrafët 1, 2 dhe 4 LPK, ai kishte humbur statusin procedural të përfaqësuesit të autorizuar, dhe *mungesa e tij në seancë ligjërishit ishte jorelevante për mbajtjen e saj. Së pesti*, sipas paditësit seanca kryesore e datës 22 mars 2011 është dashur që të shtyhet në mënyrë që të angazhojë avokat tjetër pasi që kjo ishte e drejtë e pakundërshtueshme ligjore sipas nenit 85 LPK që i jep të drejtë secilës palë për t'u përfaqësuar nga një avokat në seancë. Argumenti është ligjërishit i pa-bazuar. I cituar fjalë për fjalë, neni 85, paragrafi 1 LPK përcakton se secila palë *mund të ndërmerret veprime në procedurë personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar por gjykata mund gjithashtu të ftojë palën që ka**

përfaqësues në gjykatë që personalisht të deklarohet për faktet që duhet vërtetuar. Apo, neni 85, paragrafi 1 LPK rregullon *format* e lejueshme për *pjesëmarrje* të palëve në procedurë duke lejuar *si alternativë plotësisht të barabartë* udhëheqjen e veprimeve procedurale *personalisht apo nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar*. Pasi që efekti juridik është i njëjti sipas nenit 86, paragrafi 2 LPK, secila palë ndërgjyqëse ka të drejtë të zgjedh lirshëm pa kufizim opsionin e parë dhe/apo të dytin nga këto dy opsione. Prandaj, neni 85, paragrafi 1 LPK është i formuluar në *mënyrë jourdhëruese* – pala mundet të autorizojë përfaqësuesin e saj në lëndë, por nuk është i obliguar të *veproj kësisoj*. Ndryshe nga *mbrojtja e detyrueshme* në procedurat penale të kërkuara në fjalinë e nenit 73, paragrafi 1, nënparagrafët 1 - 4 dhe neni 74, paragrafi 1, nënparagrafët 1 - 2 KPPK, në procedurat civile *përfaqësimi bazuar në një autorizim kurrë nuk është i obligueshëm*. Rrjedhimisht, mungesa e saj vet nuk është bazë për emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm sipas nenit 79 LPK të palës pa përfaqësues të përkohshëm, *nuk përbën pengesë procedurale* në kuptim të nenit 424, paragrafi 1 LPK duke përjashtuar gjykimin e lëndës në përgjithësi dhe/apo mbajtjen e seancës kryesore sipas nenit 12, pika b) LPK si njëra nga dy fazat e procedurës së shkallës së parë. Sa kohë që neni 85, paragrafi 1 LPK i njeh secilës palë të drejtën procedurale për të autorizuar një përfaqësues, ushtrimi i saj *duhet të pajtohet me dispozitat e procedurës kontestimore* me lëshimin e autorizimit me *përmbajtje* sipas nenit 89 LPK, në *formë të shkruar* të urdhëruar me nenin 92, paragrafi 1 LPK, *të paraqitur në veprimet më të para në procedurë* nga përfaqësuesi sipas nenit 93, paragrafi 1 LPK. Pasi që *mos-ushtrimi dhe ushtrimi i paligjshëm* i të gjitha drejtave procedurale nga palët ndërgjyqëse, duke përfshirë atë sipas nenit 85, paragrafi 1 LPK, është pa asnjë pasojë ligjore, *mos-autorizimi* nga i padituri në C.nr.72/10 të Gjykatës Komonale të KAMENICËS të përfaqësuesit të ri të autorizuar sipas nenit 85, paragrafi 1 LPK në vend të Avokatit MUSTAFË MUSA nuk parashihet nga asnjë dispozitë e LPK-së *si arsye për ndërprerje apo shtyrje* gjatë procedurave. *Së gjashti*, secila palë në ndërgjyqësi ka të drejtën të ushtrojë të gjitha të drejtat procedurale *në mënyrë të ndërgjegjshme* sipas nenit 9 LPK. Gjykata ka për obligim të *mbaj seancat pa zvarritje*, dhe të *parandalojë çfarëdo shpërdorimi nga palët ndërgjyqëse* sipas nenit 10, paragrafi 1 LPK. Gjykata mund ti sanksionojë ata për të drejta procedurale të shpërdoruara në pajtim me nenin 10, paragrafin 2 LPK. Ndërmarrja Private “PROGRESS” SHPK si e paditur në C.nr.72/2010 të Gjykatës Komonale të KAMENICËS nuk ka paraqitur përgjigje në padi sipas nenit 395, paragrafi 1 LPK brenda afatit ligjor të paraparë me këtë dispozitë. Nuk është paraqitur asnjëherë ndonjë parashitje nga kjo palë ndërgjyqëse në lëndën e shkallës së parë me ndonjë kundërshtim konkret në lidhje me kontestin dhe/apo propozime për të mbledhur dëshmi lidhur me këtë. Ndërmarrja Private “PROGRESS” SHPK nuk është përfaqësuar në asnjërin nga dy seancat kryesore të caktuara në C.nr.72/2010 të Gjykatës Komonale të KAMENICËS, që rrjedhimisht ka kërkuar shtyrjen e tyre. Për seancën me 22 shkurt 2011, motivimi ishte *“udhëtim i rëndësishëm afarist në Austri”* të HEVZI XHELILIT, Drejtorit të saj. Sidoqoftë, ai nuk është vërtetuar me asnjë dokument udhëtimi dhe në atë datë ka mundur të përfaqësohet nga Avokati MUSTAFË MUSA. Për seancën e 22 marsit 2011, ishte kërkuar shtyrja për të caktuar avokat tjetër për shkak se periudha kohore ishte e shkurtër për të gjetur përfaqësues të

ri, edhe pse i padituri kishte *tri javë* nga 28 shkurti 2011, datë e revokimit të autorizimit nga Avokati MUSTAFË MUSA, deri më 22 mars 2011, data e seancës kryesore, e cila *do të duhej ti mjaftonte* kësaj palë ndërgjyqëse për të autorizuar një *përfaqësues të ri* sipas nenit 85, paragrafi 1, fjalia e dytë LPK. Këto tri javë ishin *ligjërish të mjaftueshme për autorizim të ri*, duke marrur parasysh periudhën kohore të përcaktuar me nenin 402, paragrafi 1 LPK për thirrjen e palëve dhe *përgatitjen e tyre për secilën seancë e cila është 7 ditë*. Brenda këtij minimumi i padituri është dashur të ketë angazhuar avokatin e ri në bazë të nenit 85, paragrafi 1 LPK apo është dashur të ketë përgatitur pjesëmarrjen e tij në seancën kryesore me 22 mars 2011 nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor sipas nenit 75, paragrafët 1 dhe 3 LPK. I padituri nuk ka mundur të kërkojë *mosveprimin e tij subjektiv prej tri javëve* për të shfrytëzuar ndonjërin nga këto mundësi procedurale alternative për shtyrjen e seancës kryesore me 22 mars 2011 pasi që, si rregull, *asnjë palë ndërgjyqëse nuk mund të përfitojë nga pasiviteti i saj procedural, të shprehur në mos-ushtrimin e të drejtës apo mungesa të tjera*. Duke pasur parasysh sjelljen e përgjithshme të paditurit në lëndë, respektivisht mos-pjesëmarrjen sistematike në seanca dhe kërkesat pasuese për shtyrje, me kërkesën e fundit në seancën e 22 marsit 2011 *kjo palë shpërdoroi të drejtat e saj procedurale me qëllim të zvarritjes së procedurave*, siç konstatohet plotësisht nga Gjykata Komunale e KAMENICËS. Prandaj, vendimi i saj për të mbajtur seancën kryesore me 22 mars 2011 *në mungesë të pajustificuar të të paditurit të ftuar në mënyrë të rregullt* përputhet me nenin 423, paragrafin 4 LPK, dhe detyra e kësaj gjykate të shkallës së parë sipas nenit 10, paragrafi 1 LPK *për të gjykuar lëndën pa vonesa dhe për të parandaluar çfarëdo shpërdorimi të të drejtave të dhëna palëve me LPK*. *Së shtati*, në kundërshtim me pretendimet në ankesë, pas seancës kryesore me 22 mars 2011, ajo ishte shpallur e hapur sipas nenit 423, paragrafi 1 LPK, Gjykata Komunale e KAMENICËS *kontrolloi pranishmërinë e palëve të ftuara, vërtetoi arsyet për mos-shfaqje të të paditurit sipas nenit 423, paragrafi 2 LPK, e cilësoi atë si të paryeshëm dhe vendosi që të mbaj seancën në mungesë të tij sipas nenit 423, paragrafi 3 LPK*. Në këtë mënyrë gjykata e shkallës së parë mbështeti zhvillimin e obligueshëm në mbajtjen e seancës kryesore dhe nuk e ka shkelur atë. Për të gjitha arsyet e dhëna më lart, mos-aprovimi i kërkesës së paditurit rreth shtyrjes së seancës kryesore të datës 22 mars 2011 po ashtu nuk ishte shkelje procedurale – *së pari*, ajo nuk ishte arsyetuar me asnjë nga arsyet për shtyrje, shterimisht të listuara në nenin 437, paragrafin 1 dhe nenin 438, paragrafin 1 LPK; *së dyti*, ka qenë e palejueshme – sipas nenit 428, paragrafi 2 LPK, njëra dhe pala e njëjtë mund të propozojë shtyrjen e seancës kryesore vetëm *një herë*, kurse i padituri ka propozuar dy herë- me 22 shkurt 2011 dhe me 22 mars 2011; *së treti*, kjo e fundit ka qenë në kundërshtim me nenin 441, paragrafi 1 LPK për shtyrjen e seancës *për një periudhë të pacaktuar kohore*, deri në caktimin e avokatit të ri për të paditurin në lëndë. Për të përmbledhur, *nuk ka asnjë veprim të paligjshëm të Gjykatës Komunale të KAMENICËS se i ka mohuar mundësinë të paditurit për të ndjekur seancën kryesore me 22 mars 2011*. Kjo palë i ka mohuar vetes të drejtën për të marrur pjesë në seancën e njëjtë, *duke shpërdorur të drejtën e saj procedurale sipas nenit 85, paragrafi 1 LPK për vonesa ligjërish të pajustificueshme në procedurë*.

27. Brenda kufizimit të ekzaminimit ankimor të definuar në mënyrë të domosdoshme me nenin 194 LPK, gjykata e shkallës së dytë konkludon se shkelja e dispozitave të procedurës kontestimore sipas nenit 182, paragrafi 2, pika i) LPK të shënuara në ankesë dhe atyre në nenin 182, paragrafi 2, pikat b), g), j), k) dhe m) LPK, të kontrolluara *ex officio*, nuk ekzistojnë. Asnjë shkelje tjetër procedurale, pa marrë parasysh realitetin e tyre, nuk mund të ekzaminohet brenda kufizimit të lejueshëm të ekzaminimit ankimor. Për këtë arsye aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë nuk mund të anulohet për arsye procedurale sipas nenit 181, paragrafi 1, pika a) LPK.

***Vërtetim jo i plotë dhe i gabueshëm i gjendjes faktike sipas nenit 183 LPK***

28. Baza e *dytë* në ankesë është sipas nenit 181, paragrafi 1, pika b) LPK for vërtetim jo të plotë dhe të gabueshëm të gjendjes faktike. Sidoqoftë, ajo është gjithashtu e pa-bazuar sipas kriterëve të nenit 183, paragrafi 1 LPK – gjykata e shkallës së parë nuk ka përcaktuar asnjë fakt të materialit relevant në mënyrë të padrejtë dhe nuk ka dështuar së konstatuari.

29. Në mënyrë të padiskutueshme konstatohet se me 1 dhjetor 2008 SHABAN PAJAZITI nga PRISHTINA, si *shitës* dhe Ndërmarrja Private “PROGRESS” Shëqori me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK) –fshati SHILLOVË, Komuna e GJILANIT e përfaqësuar nga drejtori HEVZI XHELILI nga fshati PËRLEPNICË, komuna e GJILANIT si *blerës* lidhën me shkrim kontratë për shitblerje të pasurisë së patundshme Vr.nr.395/2009, të vërtetuar nga Gjykata Komunale e KAMENICËS me 16 mars 2009. Palët ishin pajtuar se në momentin e lidhjes së saj, SHABAN PAJAZITI ishte *mbajtës i të drejtës së shfrytëzimit për 99 vite* duke e llogaritur prej 21 nëntorit 2006 të ngastrave kadastrale me nr.1684/1, 1684/2, 1713, 1714/1, 1715, 2890 dhe ndërtesat e konstruara në ngastrat kadastrale nr.2890-00001, 00002, 00003, 00004, dhe 00005, të regjistruara në Certifikatën nr.UL-71107033-00417 (Lista Poseduese nr.417) – neni 1.1. E drejta e shfrytëzimit të kësaj prone të paluajtshme ishte *blerë* nga SHABAN PAJAZITI prej Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) me anë të tenderit të hapur dhe publik me oferta të mbyllura – procedura e shitjes me likuidim, të organizuar nga Zyra Rajonale e GJILANIT si shitje publike GJI-0601, numri i artikullit 01, të përshkruar si “lokalet e fabrikës PIONEER”, të shfrytëzuar në të kaluarën për prodhimin e tekstilit–neni 1.2. Me 21 nëntor 2006, SHABAN PAJAZITIT iu kishte dorëzuar kjo pasuri e patundshme nga AKM bazuar në Marrëveshjen për Transferimin e Pasurisë së Patundshme Pr.nr.111/2006 – neni 1.3. me 14 dhjetor 2006, me Vendimin nr.314-358/2006 të Zyrës Kadastrale-KAMENICË, SHABAN PAJAZITI në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme ishte regjistruar *si mbajtës i së drejtës për shfrytëzim të kësaj prone të patundshme për 99 vite* - 1.4. I njëjti duke shprehur vullnetin e tij të lirë ia *shiti* atë “PROGRESS”SHPK-së për shumën e përgjithshme prej 600 000 Eurove – neni 2.1 dhe 2.2. Palët u pajtuan se *pagesa e saj e plotë do të bëhet tërësisht (100 %, 600 000 Euro) pas aprovimit të kredisë nga bankat përkatëse* – neni 3, me transferim

në llogari të shitësit nr.1501001005846864 në “RAIFFEISEN BANK të Kosovës” JSC – neni 4. Palët gjithashtu u pajtuan se një çmim tjetër mund të paguhet vetëm me pajtim të përbashkët para skadimit të afatit prej 24 muajve pas nënshkrimit të kontratës dhe vërtetimit të saj nga gjykata – neni 10.1, si dhe shitësi nuk mund të kërkojë nga blerësi ndryshimin e saj para afatit të njëjtë–neni 10.2. Kjo kontratë ishte nënshkruar nga SHABAN PAJAZITI (Letërnjoftimi i UNMIK-ut 1014870098) dhe HEVZI XHELILI (Letërnjoftimi i UNMIK-ut ID 1005904672) për “PROGRESS” SHPK, e vërtetuar nga Gjykata Komunale e KAMENICËS si Vr.nr.395/09 me 16 mars 2009.

**30.** Në mënyrë të padiskutueshme konstatohet se SHABAN PAJAZITI ka plotësuar të gjitha obligimet në mënyrë të rregullt si shitës nën këtë kontratë-duke dorëzuar pronën e patundshme “PROGRESS” SHPK-së, të përshkruar në nenin 1.1, së bashku me të gjitha dokumentet përkatëse, në bazë të të cilave ky blerës ishte regjistruar si *mbajtës i të drejtës së shfrytëzimit për kohë të caktuar - 99 vite*, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2003/13, të dëshmuar me Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme nr.UL-73507033-00417 të lëshuar nga DGJKP – KAMENICË me 17 korrik 2009.

**31.** Bazuar në deklaratat e dëshmitarit ALUSH SEJDIU i cili është marr në pyetje në seancën për shqyrtim kryesor me 22 mars 2011, Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se palët në Kontratën e kontestuar janë pajtuar gojarisht që çmimi i përgjithshëm shitblerës prej 600 000 Euro do të paguhet nga ana e blerësit përmes transferit në llogarinë bankare të shitësit në dy këste – kësti i parë në shumë prej 400 000 Euro brenda 1 muaji nga lidhja e Kontratës, dhe kësti i dytë prej 200 000 Euro brenda 24 muajve pas lidhjes së Kontratës dhe pas vërtetimit në Gjykatë. Me që kësti i parë nuk është paguar një kohë të gjatë pas kalimit të afatit fillestar, në fund të vitit 2009 palët gojarisht e vazhduan afatin deri me 31 janar 2010. SHABAN PAJAZITI e paralajmëroi HEVZI XHELILIN, Drejtorin e “PROGRESS” ShPK, se për shkak të mospagesës brenda këtij afati të ri ai do të heq dorë nga Kontrata. Dëshmitari ALUSH SEJDIU ishte prezent gjatë lidhjes dhe vërtetimit të Kontratës sikurse edhe gjatë bisedimeve të palëve për ndryshimet që pasuan gojarisht në Kontratë lidhur me pagesën e çmimit shitblerës. Gjykata e shkallës së parë i dha besim dëshmimeve të tij si konkrete, objektive, logjike sikurse edhe që korrespondojnë me të gjitha provat tjera të shtjelluara. Thëniet në arsyetimin e këtij Aktgjykimi të marr përfshijnë faktet e themeluara nga ky dëshmitar dhe vlerësimin e deklaratave të tij, siç kërkohet me nenin 160, paragrafi 4 LPK. Të njëjtat kanë *vlerat e tyre dëshmuese* sipas Neneve 339 – 355 LPK, ndonëse palët nuk janë dëgjuar nga ana e Gjykatës së shkallës së parë sipas Neneve 373 – 378 LPK *për shkak të mungesës së propozimit të tillë sipas Nenit 425, paragrafi 1, pika c) LPK të parashtruar nga ndonjëri prej tyre*. Përkundër mendimit të ankuesit, dëgjimi i palëve sipas Neneve 373 – 378 LPK kurrë nuk është e detyrueshme, nuk mund të zhvillohet *sipas detyrës zyrtare* dhe nuk është paraparë në mënyrë normative si kusht për ligjshmëri të gjyqimit të shkallës së parë.

32. Nuk është i kontestueshëm fakti se “PROGRESS” ShPK nuk ka paguar çmimin shitblerës prej 600 000 Euro as plotësisht e as pjesërisht. Nuk ka pasur një transfer të tillë në llogarinë e tanishme private të SHABAN PAJAZITIT, të specifikuar në Nenin 4 të Kontratës Vr.395/2009, e datës 16 mars 2009, e as ndonjë formë tjetër pagese të çmimit brenda ndonjë afati ose pas kalimit të afateve.

33. Gjykata e shkallës së parë nuk ia dha besimin letrës së lëshuar me Logon e “TEB” JSC – Zyra në GJILAN se HEVZI XHELILI, pronari i “PROGRESS” ShPK, me 16 korrik 2009 ka aplikuar në këtë bankë për hua prej 1 500 000 € duke u arsyetuar me mungesë të parakushteve të nevojshme, e që janë të detyrueshme për vlefshmërinë e një dokumenti të tillë bankar (numri, data, pozita e personit i cili e ka nënshkruar atë), sikurse edhe me përmbajtjen e tij, pa vërtetuar dhënien e kredisë bankare. Kjo nuk është përgënjeshtuar nga letra e “TEB” JSC – Zyra në GJILAN, e datës 15 prill 2011, e cila ishte bashkëngjitur ankesës, se kërkesa e “PROGRESS” ShPK plotësuar me 16 korrik 2009 për një hua në shumë prej 1 350 000 € dhe mbi tërheqje në shumë prej 150 000 € është refuzuar.

34. Gjendja faktike në ankesë korrespondon me atë që përmban Aktgjykimi C.nr.72/10 i Gjykatës Komunale të KAMENICES, i datës 22 mars 2011 për sa i përket fakteve sipas Nenit 319, paragrafi 2 LPK, që ishin relevante për marrjen e tij. Do me thënë, në mënyrë eksplicite është pranuar nga ankuesi lidhja e Kontratës, afatet përfundimtare për pagesën e tërë çmimit shitblerës për 2 vjet pas vërtetimit të Kontratës, sikurse edhe mospagesa e çmimit deri në kalimin e afatit me 16 mars 2011. Ky pranim i pa-tërhequr i këtyre fakteve i ka vlerat e veta dëshmuese të cilat përjashtojnë nevojën që duhet të vërtetohet sipas Nenit 321, paragrafi 2 LPK, pa ndonjë vlerësim për sa i përket Nenit 321, paragrafi 3 LPK. Faktet tjera të përmendura në ankesë lidhur me bisedat para vërtetimit formal të Kontratës, keqësimi i marrëdhënieve ndërmjet palëve, trendi i ndryshuar i tregut për sa i përket vlerës së pronave të paluajtshme të kontestuara, motivet e shitësit për të hequr dorë, tentimet e blerësit për të marr kredi bankare janë ligjërisht të pavend sipas kritereve të Nenit 319, paragrafi 2 LPK. Prandaj, mos-vërtetimi i tyre nga Aktgjykimi i shkallës së parë nuk përjashton të kompletuarit dhe korrektësinë e gjendjes faktike. Të përmbledhim, të gjitha argumentet e ankuesit lidhur me arsyen e dytë në ankesë me Nenin 181, paragrafi 1, pika a) LPK, janë të pabazuara – gjendja faktike e vërtetuar nga Gjykata e shkallës së dytë nuk është as e gabuar e as pakompletuar sipas Nenit 183 LPK.

**Zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale - Neni 184 LPK**

35. Sipas Nenit 194 LPK kjo Gjykatë e shkallës së dytë do të ekzaminoj Aktgjykimin e atakuar brenda kufijve të arsyeve të cekura në atë ankesë, sikurse sipas detyrës zyrtare për aplikimin e gabueshëm e së drejtës materiale sipas Nenit 184 LPK.

36. Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore (Titulli origjinal: *Zakon o obligacionim odnosima* e shpallur në Gazetën Zyrtare të RSFJ, No. 29/1978, amendamentet në Nr. 39/1985, 45/1989 dhe 57/1989; amendamentet përfundimtare në Gazetën Zyrtare RFJ

FRY Nr.31/1993) (“LMD”), në fuqi nga 1 tetor 1978 e tutje është Ligj i *aplikueshëm* në këtë padi sipas Nenit 1.1, pika (b) e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24, të ndryshuar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/59. Sipas Nenit 124 LMD, me *kontratat bilaterale*, nëse njëra palë *dështon t’i përmbush obligimet e veta*, pala tjetër, *veç nëse diçka tjetër është përcaktuar*, mund të kërkoj përmbushjen e obligimit ose, *sipas kritereve të Neneve 125 – 132 LMD, mund ta mos e pranoj kontratën, nëse anulimi i saj nuk mund të kryhet në baza ligjore.*

**37.** *Heqje dorë nga Kontrata* është instrument i dhënë titullarit të së drejtës, që rrjedh nga kontratat bilaterale, kur obligimi - i kundërt përkatës nuk përmbushet nga pala tjetër. Me që mos-përmbushja nuk e anulon vet kontratën bilaterale, përderisa obligimet në vet përmbajtjen e saj janë të ndërlidhura, kreditori ka të drejtë të mos e pranoj atë pas mosrespektimit të kushteve në te nga ana e debitorit. Me që *përmbushja* e obligimeve e njëres nga palët kërkon përmbushjen e obligimeve të palës tjetër, *mos-përmbushja* e tyre duhet të neutralizohet përmes kundërshtimit paraparë me Nenin 122 LMD, ose përmes të së drejtës për heqje dorë sipas nenit 124 LMD. Kjo e fundit është *ndihmëse* (paraqitet vetëm nëse është lidhur kontrata bilaterale), *dytësore* (bazohet mbi mos-përmbushjen si një fakt dytësor juridik, pas atij kryesor të lidhjes së saj), dhe *themelore* (e ushtruar në mënyrë të njëanshme nga ana e palës – titullarit të saj, që prodhon, si ndryshim ligjor – ndërprerjen e kësaj kontrate të papërmbushur). Në këtë rast ekzistojnë parakushtet për heqje dorë nga Kontrata sipas Nenit 124 LMD.

**38.** Me Kontratën e kontestuar për shitblerje të pronës së paluajtshme Vr.nr.395/09, të vërtetuar nga Gjykata komunale e KAMENICËS me 16 mars 2009, SHABAN PAJAZITI *si shitës e morri obligimin* për bartje të “PROGRESS” ShPK si blerës të së drejtës së shfrytëzimit 99-vjeçar të ngastrave kadastrale nr.1684/1, 1684/2, 1713, 1714/1, 1715, 2890 dhe ndërtesave të ngritura mbi ngastrat kadastrale nr.2890-00001, 00002, 00003, 00004, 00005, të regjistruara në Certifikatën nr.UL-71107033-00417 (Lista Poseduese nr.417), ZK KËRMJAN I POSHTËM/DONJE KORMINJANE dhe t’i dorëzoj të blerësi, ndërsa ky i fundit e morri obligimin për ta paguar çmimin dhe ta marrë në dorëzim posedimin e pronës. Para kësaj, që i nënshtrohet kufizimeve të paraqitura me rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Shoqërore, *e drejta në shfrytëzim* mbi ngastrat e njëjta dhe ndërtesat mbi ato ngastra, të regjistruara në emër të N.Sh. “FABRIKA E TEKSTILIT–NITEKS”, ishte *transferuar* të korporata subsidiare e kësaj ndërmarrjeje shoqërore në përputhje me Nenin 8 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/12, e transformuar në *qiramarrje*, duke përfshirë, *inter alia*, të drejtën në posedim dhe shfrytëzim për 99 vjet (Neni 2.1 (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13), dhe e bartur nga AKM-ja të SHABAN PAJAZITI përmes Marrëveshjes Pr.nr.111/06, të datës 21 nëntor 2011 (Neni 2.1 (b), Neni 2.3 dhe Neni 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2003/13). Kështu e fituar, kjo qiramarrje nuk mund të ndikohej nga *ndryshimet fizike* të pronave– lënda e saj ose nga *ndryshimet ligjore* të pronësia themelore (Nenet 7 dhe 8 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13). Duke qenë me *veti të bartjes së lirë* të palët e treta (Neni 2.1 (c) të Rregullores së UNMIK-

ut Nr.2003/13), kjo qiramarrje ishte shitur përmes Kontratës së kontestuar nga SHABAN PAJAZITI te “PROGRESS” SHPK (Neni 2.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13). Edhe duke pasur këtë *tërësi specifike të të drejtave* për lëndë të saj, sipas kualifikimit ligjor kjo është një *shitje* sipas Nenit 454, paragrafi 2 LMD. Ajo ishte lidhur *me shkrim dhe ishte vërtetuar nga Gjykata* me 16 mars 2009 në pajtim me Nenin 4, paragrafi 2 të Ligjit mbi Shitblerjen e Pronës së Paluajtshme (e shpallur në Gazetën Zyrtare të SRS, Nr. 43/1981, 24/1985, 28/1987, 6/1989 dhe 40/1989) lidhur me Nenin 3.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13. Kjo bartje e qiramarrjes ishte *regjistruar në Kadastër* sipas Nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13. Veçmas nga pajtueshmëria me këto kritere formale të detyrueshme lidhur me vlefshmërinë e saj, *përmbajtja e saj përfshinë elementet konstituive të çdo pjese të shitjes* – 1) *objekt* sipas Nenit 458, paragrafi 1 LMD, *çka është e mundur, e lejuar* (në shitblerje/tregti) dhe *e vërtetuar* sipas Nenit 46, paragrafi 2 LMD - 6 ngastra kadastrale dhe 5 ndërtesa mbi ato ngastra, të specifikuara me shënimet e regjistrimit të tyre, nën pronësinë shoqërore me qiramarrje, duke përfshirë të drejtën e shfrytëzimit 99-vjeçar; 2) *çmimi – i përcaktuar me Kontratë në çmim të përgjithshëm prej 600 000 Euro* sipas Nenit 462, paragrafi 1, fjalia e parë lidhur me Nenin 394 LMD, *jo lëndë e vërtetimeve të tjera*, do me thënë me çmim të dakorduar (Neni 463 LMD), çmimi i tanishëm i përcaktuar (Neni 464 LMD), nga pala e tretë (Neni 464 LMD) ose nga partneri i bisedimeve për shitblerje (Neni 465 LMD). Me që palët arritën një marrëveshje për sa i përket këtyre elementeve themelore konstituive (kushtet) për kontratën e shitblerjes, kontrata e kontestuar *ishte lidhur* sipas Nenit 26 LMD dispozitat ligjore të aplikueshme për këtë Kontratë duke i plotësuar dhe zëvendësuar kushtet e saj e duke mos i kundërvër atyre bazuar në Nenin 27, paragrafi 2 LMD. Kontrata nuk është nule dhe e pavlefshme, do me thënë: 1) me që *lënda* e saj nuk është e pamundur, e paligjshme, e paspecifikuar ose e pavërtetuar (Neni 47 LMD); 2) *baza e saj* nuk është jo-ekzistuese ose e palejuar (Neni 52 LMD); 3) është e lidhur ndërmjet personit fizik dhe atij juridik me *cilësinë* e paraparë sipas nenit 2 dhe Nenit 54, paragrafi LMD për të hyrë në këtë kontratë; 4) asnjëra nga të *metat e vullnetit* të lirë sipas Neneve 60 - 66 LMD janë pretenduara ose të dëshmuara për sa i përket cilës do palë; 5) me që *forma* është paraparë me ligj, sanksioni i pavlefshmërisë është i paaplikueshëm për shkak të mungesës së saj sipas Nenit 70, paragrafi 1 LMD; 6) kontrata nuk është e pavlefshme për shkak se është në kundërshtim me *rregulloret e detyrueshme, politikat e rregullimit shoqëror ose shfrytëzim të drejtë* sipas Nenit 103, paragrafi 1 LMD. I pabazuar është kualifikimi i tij si: 1) *mos-ekzistuese* sipas Nenit 63 LMD me që kurrë nuk ka pasur mosmarrëveshje ndërmjet palëve lidhur me *natyrën e kësaj Kontrate dhe/ose baza dhe lënda* për cilin do obligim të tyre; 2) *fiktive* sipas Nenit 66 LMD – nuk është e qartë për shkak të mungesës së afateve për pagesë të çmimit në përmbajtjen e saj me që kjo paplotueshmëri është plotësuar *ex lege* sipas Nenit 27, paragrafi 2 LMD përmes dispozitës së Nenit 516, paragrafi 2 LMD. Këto  *motive nuk janë vendimtare* për Aktgjykimin e shkallës së parë i cili është i bazuar në lidhjen e Kontratës së kontestuar si: 1) *shitje* sipas Nenit 454, paragrafi 2 LMD e qiramarrjes së pronave shoqërore; 2) *e dyanshme* me që ka krijuar obligime për të

dyja palët kontraktuese; 3) në *efektin e saj ligjor jo-nule dhe jo e pavlefshme ose e pa-anulueshme*. Për atë çdonjëra palë ka qene detyrimisht e lidhur me Kontratë sipas Nenit 148, paragrafi 1 LMD për t'i përmbushur obligimet e veta duke mbajtur përgjegjësi ligjore për dështim në përmbushjen e tyre sipas Nenit 17, paragrafi 1 dhe Neni 121 LMD. E dyanshme me efekte ligjore, kjo Kontratë mund të hidhej poshtë për shkak të mospërmbushjes së saj sipas Nenit 124 LMD.

**39.** “PROGRESS” ShPK ka dështuar t'i përmbush obligimet e veta si blerës për ta paguar çmimin e shitblerjes sipas Neneve 2, 3 dhe 4 të Kontratës Vr.359/2009, e datës 16 mars 2009 dhe Nenit 516, paragrafët 1-2 LMD. Mospërmbushja e këtij obligimi të vetëm monetar për shkak të vonesës së debitorit sipas Nenit 324, paragrafi 1 LMD mjafton për heqje dorë nga Kontrata sipas Nenit 124 LMD. Së pari, bazuar në rregullat e përgjithshme të Nenit 314 LMD çdo obligim duhet të përmbushet brenda afatit të përcaktuar (në mënyrë kontraktuale ose normative) për ta plotësuar atë. Në mënyrë të ngjashme, bazuar në rregullën specifike të Nenit 516, paragrafi 1 LMD blerësi duhet të obligohet të paguaj çmimin në afat të specifikuar në Kontratë, ose nëse nuk ka një klauzolë e tillë – në momentin e dorëzimit të objektit sipas Nenit 516, paragrafi 2 dhe Neni 475 LMD. Në rastin konkret Kontrata e kontestuar është lidhur me shkrim dhe është vërtetuar nga ana e Gjykatës në përputhje me kriteret formale ligjore të parapara për vlefshmërinë e saj – Neni 67 *in fine* LMD. Në përmbajtjen e saj të shkruar, të vërtetuar nga Gjykata, *afati për pagesë të çmimit nuk është përcaktuar në mënyrë eksplicite nga asnjëra prej klauzolave të saja*. Megjithatë, pasi që palët arritën marrëveshje njëkohshme gojore për këtë afat që nuk është përmendur në dokument, çka nuk është në kundërshtim me përmbajtjen e saj dhe/ose arsyet që parashohin formën e saj ligjore, ajo është valide sipas Nenit 71, paragrafi 1 LMD. Marrëveshja e tyre e mëpasshme gojore për sa i përket afatit për pagesë, e arritur në fund të viti 2009, është gjithashtu valide sipas Nenit 67, paragrafi 3 LMD. Ajo nuk është e kontestuar nga asnjëri prej ndërgjyqësve, është e vërtetuar me provat e administruara nga ana e Gjykatës së shkallës së parë dhe është në mënyrë eksplicite e pranuar nga “PROGRESS” ShPK në ankesë se palët janë pajtuar gojarisht që çmimi i përgjithshëm shitblerës prej 600 000 Euro do të paguhet plotësisht brenda 24 muajve (2 vjet) nga data e lidhjes dhe vërtetimit të saj në Gjykatë – 16 mars 2009. Duke llogaritur, sipas Nenit 77, paragrafi 2 LMD, nga kjo datë fillestare, *afati përfundimtar kaloi me 16 mars 2011*. Për atë, më së voni në këtë afat, “PROGRESS” ShPK është dashur të transferoj në llogarinë bankare nr.1501001005846864 të SHABAN PAJAZITIT në “RAIFFEISEN BANK- Kosovë” JSC, sipas Nenit 318, paragrafi 1 LMD, çmimin e dakorduar në shumën totale prej 600 000 Euro. Së dyti, nëse marrëveshjet e lartpërmendura të njëkohshme dhe/ose të mëpasshme janë në mënyrë hipotetike të konsideruar pa efekt ligjor, atëherë në mungesë të çfarë do klauzole në dokumentin e bërë me shkrim të Kontratës për sa i përket afatit për pagesë të çmimit, përmbajtja e saj do të *plotësohej* sipas Nenit 27, paragrafi 2 LMD përmes dispozitës legislative të Nenit 516, paragrafi 2 LMD, duke kërkuar që *çmimi të paguhet në mënyrë të njehershme me të dorëzuar të objektit*. Në këtë hipotezë konkrete, siç është

vërtetuar me Nenin 10, paragrafi 1 të Kontratës së kontestuar, pronat e paluajtshme të specifikuar në Nenin 1 të Kontratës janë dorëzuar në datën e lidhjes së saj me 16 mars 2009 prej SHABAN PAJAZITIT të “PROGRESS” ShPK me dokumentet e nevojshme për regjistrim të ndryshimeve përkatëse kadastrale, siç edhe kërkohet me Nenin 467, paragrafi 1 LMD. Për atë, nëse afati për pagesë të çmimit nuk është përcaktuar në mënyrë valide përmes Kontratës sipas Nenit 516, paragrafi 1 LMD, atëherë është i aplikueshëm ai i cili është i përcaktuar në mënyrë normative sipas Nenit 516, paragrafi 2 LMD që kërkon të paguhet shuma e plotë në datën e dorëzimit të pronave të paluajtshme për të cilën janë pajtuar palët në mënyrë reciproke me shitjen e të drejtës së shfrytëzimit – me 16 mars 2009. Së treti, është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme nga ana e Gjykatës së shkallës së parë dhe pranuar në mënyrë eksplicite në ankesë se “PROGRESS” ShPK nuk e ka përmbushur obligimin për ta paguar çmimin shitblerës as brenda afatit *kontraktues* përfundimtar sipas Nenit 516, paragrafi 1 LMD – 16 mars 2011, e as brenda afatit shtesë të paraparë në *mënyrë normative* sipas Nenit 516, paragrafi 1 LMD – me 16 mars 2009. Nuk ka pasur ndonjë përmbushje nga debitori ose nga një person i tretë (Neni 296, paragrafi 1 LMD), me ose pa subrogim sipas Nenit 299–304 LMD, te kreditori ose ndonjë personi tjetër të autorizuar ta pranojë atë në emër të tij sipas Nenit 305 LMD, brenda përmbajtjes së dakorduar të këtij obligimi ose të zëvendësimit të tij sipas Neneve 307 - 308 LMD, pjesërisht ose plotësisht sipas Nenit 310 LMD, para ose pas kalimit të cilit do afat sipas Neneve 314 – 318 LCT dhe/ose në çfarë do vendi për përmbushjen e afatit, sipas Neneve 319–320 LMD. Shkurtimisht, obligimi i “PROGRESS” ShPK si blerës për ta paguar çmimin nuk ka përfunduar përmes përmbushjes në fjalinë e parë të Nenit 285, paragrafi 1 LMD. Së katërti, nuk është pretenduar ose dëshmuar ndërprerja e saj as në fjalinë e dytë të Nenit 285, paragrafi 1 LMD mbi bazat e ndonjë arsyeje të paraparë me ligj – *kompensimi* sipas Neneve 336 – 343 LMD, *shlyerje borxhi* sipas Neneve 344 – 347 LMD, *zëvendësim (ndryshim)* sipas Neneve 348 – 352 LMD, *shkrirje (bashkim)* sipas Nenit 353 LMD, *parashkrim* sipas Neneve 360 – 393 LMD dhe/ose ndonjë arsye tjetër e paraparë me ligj. Për atë, ekziston *mospërmbushja e plotë* e obligimit nga “PROGRESS” ShPK për ta paguar çmimin, të marrë nga Kontrata Vr.359/2009, e datës 16 mars 2009, çka është parakusht tjetër për heqje dorë nga Kontrata sipas Nenit 124 LMD.

40. Nuk ekziston *pamundësia për përmbushje* për shkak të rrethanave objektive për të cilat “PROGRESS” ShPK si debitor i obligimeve kontraktuese për pagesë të çmimit nuk duhet të fajësohet sipas Nenit 354, paragrafi 1 LMD. Kjo palë nuk ka dëshmuar në këtë lëndë me asnjë provë *shkarkimin e tij nga përgjegjësia* për shkak të ekzistimit të rrethanave të tilla sipas barrës së provës, paraparë me Nenin 354, paragrafi 2 LMD. Për më tepër, për derisa obligimi i tij është *monetar* dhe si i tillë i specifikuar sipas llojit të tij, me Nenin 355, paragrafi 2 LMD ai obligim kurrë nuk ka mundur të kryhet për shkak të pamundësisë objektive për ta përmbushur atë.

41. Heqja dorë nga Kontrata sipas Nenit 124 LMD nuk përjashtohet gjithashtu për shkak të *papërgjegjësisë* së “PROGRESS” ShPK si debitor për mospërmbushjen e

Kontratës së kontestuar. *Së pari*, mospagesa e çmimit nuk është rezultat i *vonesës së kreditorit* në asnjërën nga alternativat. Si shitës SHABAN PAJAZITI nuk ka *refuzuar të pranojë përmbushjen* e “PROGRESS” ShPK dhe *nuk ka penguar udhëheqjen e saj* (Neni 325, paragrafi 1 LMD). Ai nuk ka dështuar të përmbush ndonjërin nga obligimet e tij të paraparë me Kontratë për përmbushjen e njëhershme bashkë me pagesën e çmimit, që duhej të paguhej nga “PROGRESS” ShPK (Neni 325, paragrafi 2 LMD). Vonesa e kreditorit ligjërisht është e pamundur në këtë rast me që “PROGRESS” SHPK *kurrë nuk i ka ofruar SHABAN PAJAZITIT çmimin* dhe për më tepër, *kurrë nuk ka pasur mjete financiare për ta paguar atë* (Neni 325, paragrafi 3 LMD). Prandaj, efekti i saj ligjor sipas Nenit 326, paragrafi 1 LMD nuk ka mundur të paraqitet – *pa vonesë të kreditorit të SHABAN PAJAZITIT*, kjo dispozitë është e paplikueshme në këtë rast - “PROGRESS” ShPK *nuk ka qenë e shkarkuar nga ndonjë pasojë ligjore për shkak të vonesës së debitorit*, do me thënë heqje dorë nga Kontrata sipas Nenit 124 LMD për shkak të shkeljes së obligimeve të tij si blerës për ta paguar çmimin. *Së dyti*, nuk ka pas kundërshtime, sipas Nenit 122, paragrafi 1 LMD, që ishte kërkuar nga “PROGRESS” ShPK në shkallë të parë ose të dytë në mënyrë që të *shfajësohet nga përgjegjësia për mospërmbushjen e obligimeve*- nuk është pohuar dhe vërtetuar se ky ndërgjyqës nuk ka paguar çmimin që ai i kishte borxh si blerës sepse SHABAN PAJAZITI nuk i ka përmbushur ose nuk ka qenë i gatshëm t’i përmbush obligimet e tija si shitës në këtë transaksion në mënyrë të *njëkohshme*. Me që dështimi nga ana e “PROGRESS” ShPK për t’i përmbushur obligimet nuk është rezultat i *kundërshtimit të ushtruar sipas Nenit 122, paragrafi 1 LMD për përmbushje të njëkohshme nga pala tjetër*, kjo i vishet debitorit si gabim i tij. *Së treti*, paraqitja e padisë në lëndën C.nr.72/2010 të Gjykatës Komunale të KAMENICËS nuk mund të jetë shkak për mospagesën e plotë të çmimit si borxh i papaguar nga “PROGRESS” ShPK, me që *nuk ka lidhje faktike dhe ligjore ndërmjet inicimit të kësaj lënde dhe mospagesës*. Padia është paraqitur me 22 prill 2010 pas kalimit të afatit prej 15 muajve nga dita e lidhjes së Kontratës me 1 dhjetor 2008, 13 muaj pas vërtetimit të saj nga ana e Gjykatës me 16 mars 2009, 12 muaj pas afatit të parë për pagesë të kështit të parë prej 400 000 Euro me 16 prill 2009 dhe 3 muaj pas afatit të mëpasshëm për pagesë të saj me 31 janar 2011. Për atë SHABAN PAJAZITI si shitës i ka dhënë "PROGRESS" ShPK si blerës *tolerancë të mjaftueshme për ta përmbushur obligimin para se të kërkoj rregullim ligjor për mospërmbushjen e tij të vazhdueshme*. Ndonëse padia ishte ushtruar me 22 prill 2010, para kalimit të afatit përfundimtar për pagesë të çmimit të dakorduar me 16 mars 2011, ajo nuk është e *parakohshme*. *Së pari*, sipas Nenit 128 LMD nëse para kalimit të afatit për përmbushje të obligimeve bëhet e qartë se pala tjetër nuk do t’i përmbush, *pala tjetër mund ta mos e pranojë Kontratën*. Kjo është hipotezë. Kur ishte kryer blerja me 1 dhjetor 2008, "PROGRESS" ShPK i mungonin mjetet financiare, të nevojshme për të paguar çmimin prej 600 000 Euro; 15 muaj pasi që është parashtruar padia, sikurse edhe 35 muaj pasi që është kompletuar procedura ankimore, kompania ende nuk kishte mundur të depozitonte parat përmes kredive bankare, investitorëve ose burimeve tjera për financim. Për shkak të rrethanave të cilat qartë demonstrojnë paafësinë e "PROGRESS" ShPK për ta paguar ndonjë shumë të

çmimit, SHABAN PAJAZITI kishte të drejtë të kërkoj ndërprerjen e Kontratës *para kalimit të afatit përfundimtar për pagesë* sipas Nenit 128 LMD. Me që ky afat kaloi me 16 mars 2011 para përfundimit të seancës dëgjimore në shkallë të parë me 22 mars 2011, sipas Nenit 144, paragrafi 3 LPK *padia nuk mund të hedhet poshtë si e parakohshme*. Kjo arsye e kërkuar nga ankuesi e kundërshton Nenin 128 LMD dhe Nenin 144, paragrafi 3 LPK, sikurse edhe Nenin 167, paragrafi 2 LPK duke përcaktuar se *marrja e Aktgjykimit është e lidhur me status të marrëdhënies së kontestuar ligjore në kohën e përfundimit të seancës për shqyrtim kryesor*. Në këtë rast procedura e shkallës së parë sipas Nenit 436, paragrafi 1 LPK kishte përfunduar me 22 mars 2011, prej së cilës datë obligimi i "PROGRESS" ShPK për ta paguar çmimin prej 600 000 Euro, *edhe pse data e pagesës kalonte me 16 mars 2011 për tërë atë shumë, ishte i pakryer*. Prandaj, mospërbushja e obligimit nga ky ndërgjyqës nuk mund të arsyetohet me *parakohshmëri* të këtij obligimi me që *përbushja e afatit të tij* ndodhi para përfundimit të seancës për shqyrtim kryesor në pajtim me Nenin 167, paragrafi 2 LPK. *Së katërti*, nuk kemi të bëjmë me *faj të kreditorit* të SHABAN PAJAZITI për shkak të *propozimit për masën e përkohshme në këtë rast, duke e liruar "PROGRESS" ShPK nga faji i tij si debitor*. Ndalesa me ligj për tjetërsim, qiradhënie, hipotekë ose ndonjë transaksion tjetër formal me pronën e kontestuar të paluajtshme ishte urdhëruar nga Gjykata Komunale e KAMENICËS sipas Nenit 300, paragrafi 1, pika a) dhe Neni 301, paragrafi 1, pikat a) dhe d) LPK me një *Aktvendim mbi masën e përkohshme*, të datës 10 gusht 2010, sipas Nenit 306, paragrafi 1 LPK, zëvendësuar me një *Aktvendim mbi masat e sigurisë*, të datës 26 gusht 2010, sipas Nenit 306, paragrafi 3 LPK. Kundërshtimi i "PROGRESS" ShPK sipas Nenit 306, paragrafi 2 LPK kundër të parit Aktvendim nuk ishte aprovuar nga Gjykata Komunale e KAMENICËS, ndërsa ankesa e tij bazuar në Nenin 310, paragrafi 1 LPK kundër të dytit Aktvendim ishte refuzuar me Aktvendimin AC.nr.333/2010 të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT, të datës 2 nëntor 2010. Për atë, ndalesat për sa i përket pronës së kontestuar të paluajtshme nuk ishin themeluar nga SHABAN PAJAZITI si kreditor por ishin caktuar me *vendimet e plotfuqishme gjyqësore*, të konfirmuara si të ligjshme pasi që ishin atakuar nga "PROGRESS" ShPK me të gjitha mjetet e mundshme juridike. Për këtë, *nuk kemi të bëjmë me fajin e kreditorit të SHABAN PAJAZITIT* lidhur me këtë masë të përkohshme/ masë sigurie, duke përjashtuar detyrimin e "PROGRESS" ShPK për dështimin e tij për ta përbushur obligimin në *mirëbesim dhe në tërësi* siç kërkohet me Nenin 263 LMD. Kjo mospërbushje e cila është ligjërisht e pajustificuar, arsyeton ndërprerjen e Kontratës sipas Nenit 124 LMD.

**42.** *Pamundësia* e "PROGRESS" ShPK për ta përbushur obligimin e tij është *subjektive, jo objektive* për shkak se: 1) ka ekzistuar vetëm për këtë kompani, jo *erga omnes* për palët e treta - Neni 364, paragrafi 1 LMD; 2) nuk është shkaktuar nga rrethanat e paraqitura së fundi pas lidhjes së Kontratës së kontestuar të cilën gjë debitori nuk ka mundur ta eliminojë ose t'i shmanget – Neni 263 LMD. *Së pari*, nga data 16 mars 2011, kur kaloi afati i fundit për pagesën e çmimit, dështimi i "PROGRESS" ShPK për ta përbushur këtë obligim paraqet *vonesë të debitorit* sipas

Nenit 324, paragrafi 1 LMD *për ato arsye për të cilat kjo palë është përgjegjëse*. Kjo tolerance 2-vjeçare falas e afatit kontraktues kryesisht e tejkalon njëren arsye e cila është adekuate për përmbushjen e përmendur dhe është e zakonshme për transaksione ligjore të këtij lloji apo vlere. Megjithatë, deri në kalimin e afatit “PROGRESS” ShPK nuk ka siguruar shumën e çmimit nga shuma e parave e fituar nga shitja e veprimtarive të biznesit ose nga shitja asetëve të përdorshme, nuk ka marrë kredi bankare nga asnjëra prej bankave komerciale, të licencuara në Kosovë, nuk ka gjetur burime alternative financiare, dhe nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim tjetër ligjor dhe faktik të nevojshëm për pagesën e borxhit SHABAN PAJAZITIT. Së dyti, është e padëshmuar thënia në ankese se “PROGRESS” ShPK nuk ka mundur të marrë kredi bankare për shkak të masës së përkohshme të urdhëruar me Aktvendimin C.nr.72/2010 të Gjykatës Komunale të KAMENICËS, të datës 10 gusht 2010. Në mungesë të ndonjë dokumenti të lëshuar nga ndonjë bankë komerciale në Kosovë ose dëshmie tjetër që konfirmon se kredia bankare e kërkuar nga “PROGRESS” ShPK është refuzuar *për shkak të kësaj mase të përkohshme* duke zbatuar rregullën e barrës së provës sipas Nenit 322, paragrafi 1 LPK Gjykata duhet të konkludoj se *nuk ekziston një refuzim i tillë*. Për më tepër, masa e përkohshme ishte marrë me 10 gusht 2010 dhe nuk ka mundur ta arsyetoj në mënyrë retroaktive mosmarrjen e ndonjë kredie bankare nga “PROGRESS” ShPK në 19 muajt e kaluar pas lidhjes së Kontratës me 1 dhjetor 2008. Më tej, as Aktvendimi C.nr.72/2010 i Gjykatës Komunale të KAMENICËS, i datës 10 gusht 2010 për *masën e përkohshme* sipas Nenit 306, paragrafi 1 LPK, e as Aktvendimi C.nr.72/10 i Gjykatës Komunale të KAMENICËS, i datës 26 gusht 2010 për *masën e sigurisë* sipas Nenit 306, paragrafi 3 LPK nuk ishin dërguar *sipas detyrës zyrtare* bazuar në Nenin 307, paragrafi 1, fjalia e dytë LCP për ekzekutim të detyrueshëm ose për regjistrim në Regjistrin mbi të drejtat e pronës së paluajtshme. Si pasojë, Aktvendimi i dytë nuk ka prodhuar, sipas Nenit 307, paragrafi 3, fjalia e parë LPK, *efekt ligjor i një titullari ekzekutiv*, sipas Ligjit Nr. 03/L-008 mbi Procedurën Përmbartimore, sikurse edhe *nuk është bërë detyrues për personat e tretë* sipas Nenit 307, paragrafi 3, fjalia e dytë LPK sepse ata nuk mund të konsideroheshin të informuar për këtë masë të sigurisë me hyrjen në këtë Regjistër publik siç parashihet me Nenin 7.2 të Ligjit Nr. 2002/5 mbi Regjistrin për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 2003/13. Më në fund, siç është dëshmuar me Certifikatën nr.UL-71107033-00417, ZK KËRMJAN I POSHTËM/DONJE KORMINJANE, prona e kontestuar e paluajtshme është ende në emër të N.Sh. “FABRIKA E TEKSTILIT-NITEKS” *si pronë shoqërore*. Ky status përjashton themelimin e *hipotekës* mbi këtë pronë si kolateral për ndonjë kredit bankare të “PROGRESS” ShPK. *Pa qenë pronar* i ngastrave kadatsrale nr.1684/1, 1684/2, 1713, 1714/1, 1715, 2890 dhe/ose ndërtesave mbi ngastrat kadatsrale nr.2890-00001, 00002, 00003, 00004, 00005, kjo kompani private nuk ka të drejtë, sipas Nenit 173 dhe Nenit 174, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, të lidhë marrëveshjen mbi hipotekë me ndonjë kreditor hipotekar (duke përfshirë edhe bankën) për krijimin e hipotekës mbi këto prona të paluajtshme. Më tej, me që *vetëm e drejta e shfrytëzimit 99-vjeçar*, sipas Nenit 2.1, pika a) të

Rregullores së UNMIK-ut Nr.2003/13, ishte shitur përmes Kontratës (shiko përkufizimet e saj të definuar me Nenin 1) dhe *anasjelltas*, asnjë nga të drejtat tjera – elementet e qiramarrjes në atë pronë të kontestuar të paluajtshme, të paraqitur në Nenin 2.1, pikat b) dhe c) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/13, *e drejta për të themeluar barra*, nuk janë transferuar te “PROGRESS” ShPK. Duke qenë në pronësi shoqërore kjo pronë nuk ka mundur të vendoset nën hipotekë si kolateral i kredisë bankare nga *kjo kompani private e cila nuk është pronare e saj por vetëm mbajtës i së drejtës së shfrytëzimit për kohëzgjatje prej 99-vjetëve*. Këto përkufizime ligjore si pasojë e statusit pronësor të pronës së paluajtshme – objekt i qiramarrjes që është shitur përmes Kontratës së kontestuar *ka ekzistuar në momentin e lidhjes së saj dhe nuk ka ndodhë pas hyrjes së saj në fuqi* siç kërkohet me Nenin 263 LMD për heqjen dorë të “PROGRESS” ShPK nga detyrimi i tij si debitor për shkak të mospërbushjes. Për derisa nuk ekziston pamundësia e përbushjes së obligimit monetar, sipas nenit 354, paragrafi 1 LMD, nga “PROGRESS” ShPK si blerës për ta paguar çmimin e papaguar për qiramarrje të blerë nga SHABAN PAJAZITI si shitës - Neni 355, paragrafi 1 LMD, ndërsa vonesa në përbushjen e obligimit nuk është shkaktuar nga kreditori – Neni 325, paragrafët 1 dhe 2 LMD, është e papaguar për shkak të arsyeve për të cilat debitori detyrohet për pagesë të borxhit, pa qenë i liruar nga detyrimet – Neni 263 LMD. Mungesa e mjeteve financiare nuk e liron “PROGRESS” ShPK nga pasojat e dështimit për ta kryer obligimin e vet, si një parakusht sipas Nenit 124 LMD për heqjen dorë nga Kontrata.

43. Gjithashtu janë plotësuar kushtet dhe përkufizimet tjera normative të paraqitur për këtë heqje dorë. *Së pari*, ato nuk janë hequr ose ndryshuar nga ana e palëve nga ndonjë veprim që është përcaktuar në Kontratën e kontestuar që përjashton ose kufizon zbatimin e Nenit 124 LMD në këtë rast. *Së dyti*, nuk kemi të bëjmë me anulimin e Kontratës së kontestuar që është kryer mbi bazë ligjore, e që nuk është në pajtim me heqjen dorë nga ana e njërës prej palëve pas dështimit të tjetrit të kryej obligimin e tij. *Së treti*, me që pagesa e çmimit brenda afatit të caktuar nuk ishte element themelor (kusht) i Kontratës, ajo nuk ishte zgjidh *ex lege* sipas Nenit 125, paragrafi 1 LMD për shkak të dështimit të “PROGRESS” ShPK ta bëjë pagesën me kohë. Edhe pse me efekt ligjor të rezervuar, sipas Nenit 126, paragrafi 1 LMD, heqja dorë nga pala tjetër është e pranueshme *pa i lënë shpërdoruesit një afat pasues kohor për përbushjen e detyrimi*, sipas Nenit 126, paragrafi 2 LMD bazuar në përjashtim sipas Nenit 127 LPK sepse sjellja e shpërdoruesit tregon paaftësi për ta përbushur obligimin e tij brenda një zgjatjeje të tillë afati. Për arsyet e njëjta, heqja dorë nga Kontrata është bërë e pranueshme *para kalimit të afatit përfundimtar* për pagesë të çmimit sipas Nenit 128 LMD. *Së katërti*, mospërbushja në fjalë ndikon në obligimin esencial të blerësit sipas Nenit 516 LMD për të paguar çmimin dhe vetvetiu është i rëndësishëm me që çmimi prej 600 000 Euro është plotësisht i papaguar. Për atë, heqja dorë nga Kontrata nuk është e pamundur sipas Nenit 129 LMD për shkak të moskryerjes (shkelje) së një kushti të vogël të Kontratës – mospërbushja e saj nga blerësi arrin në 100 % dhe nuk është e vogël as në mënyrë absolute e as relative për

*sa i përket interesit të shitësit.* Motivet e tij, të përmendur në ankesë, janë ligjërisht të pavend për të drejtën e tij sipas Nenit 124 LMD për ta ndërprerë Kontratën, tërësisht e papërbushur nga ana e palës tjetër gati 3 vjet pas lidhjes së saj me 1 dhjetor 2008, një kohë të gjatë pas kalimit të afateve të llojllojshme. Kjo e drejtë nuk është *dytësore ose përndryshe e varur* nga e drejta e tij si kreditor, sipas Nenit 124 *in fine*, Neni 262, paragrafi 3 dhe Neni 266, paragrafi 1 LMD, *për kompensim të dëmeve të mbajtura që pasuan pas vonesës së njëjtë të debitorit.* Prandaj, heqja dorë nga Kontrata në këtë rast nuk është e palejueshme për shkak se është kërkuar *veçmas* nga dëmet e shkaktuara për shkak të moskryerjes së obligimeve- bazat e saj. Më në fund, *veç përkufizimeve normative* të përmendur më lartë, *nuk ka tjera si shtesë* të dakorduara nga ana e palëve që përjashton zgjidhjen e Kontratës në këtë rast. Me që është kërkuar *vetëm për shkak të moskryerjes* së obligimit, rregullat për heqje dorë nga Kontrata janë të paaplikueshme *për shkak të rrethanave të ndryshuara (mundim)* si të parashtruar me Nenet 133 – 136 LMD.

44. Kontrata e kontestuar ligjërisht është hedhur poshtë me Aktgjykimin e ankimuar për *moskryerjen e obligimit* të “PROGRESS” ShPK si blerës për ta paguar çmimin që ia kishte borxh SHABAN PAJAZITIT si shitës të qiramarrjes mbi pronën e paluajtshme- si objekt i Kontratës. Parakushtet dhe përkufizimet për këtë ndërprerje të Kontratës ishin në pajtueshmëri me Nenet 124 – 131 LMD. Dështimi për të përbushur Kontratën nga ana e kësaj pale ishte aq i dukshëm dhe i vazhdueshëm sa që qëllimi i saj nuk mund të realizohej në interes të ndërsjellë për të dyja palët dhe do të ishte e padrejtë të ruhet validiteti i saj, e përbushur në mënyrë të njëanshme vetëm nga njëra palë. *Pasojat* e heqjes dorë nga Kontrata e deklaruar janë vërtetuar nga Gjykata e shkallës së parë në përputhje me efektin e paraparë ligjor. Me që i liroj të dyja palët nga obligimet e tyre sipas Kontratës, përveç asaj të “PROGRESS” ShPK për kompensim të dëmit pasues, sipas Nenit 132, paragrafi 1 LPK, dëmshpërblimi për atë çka është dhënë mbi bazat e saj paraparë në Nenin 132, paragrafi 2 LMD, është realizuar duke urdhëruar organin kompetent të DGKP ta bëjë çregjistrimin e “PROGRESS” ShPK si mbajtës të blerjes së drejtës së shfrytëzimit të qiramarrjes 99-vjeçare dhe ta regjistroj në emër të SHABAN PAJAZITIT si titullar i së njëjtës drejtë para shitjes së saj të pavlefshme.

45. Duke e marrë Aktgjykimin e ankimuar Gjykata e shkallës së parë as nuk dështoi në zbatimin e dispozitave të sakta nga e drejta materiale, e as nuk i zbatoj ato në mënyrë të pasaktë *për sa i përket kriterëve të përcaktuara me Nenin 184 LPK.* Kjo arsye e tretë lidhur me atakimin e Aktgjykimit sipas Nenit 181, paragrafi 1, pika c) LPK për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale është gjithashtu e pabazuar.

## VI. Konkluzioni

46. Pas ekzaminimit ankimor, Gjykata e shkallës së dytë vendosi të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe ta vërtetoj Aktgjykimin C.nr.72/10 e Gjykatës Komunale të KAMENICËS, i datës 22 mars 2011 sipas Nenit 195, paragrafi 1, pika d) në lidhje


me Nenin 200 LPK. Ky Aktgjykim është marrë në mënyrë të ligjshme pa baza për ta atakuar atë sipas Nenit 181, paragrafi 1, pikat a) - c) LPK siç kërkohet me ankesë ose ndryshe të identifikuar sipas detyrës zyrtare në këtë procedurë të shkallës së dytë për sa i përket aprovimit të padisë sipas Nenit 124 LMD dhe kompensimit të procedurës gjyqësore sipas Nenit 452, paragrafi 1 LPK.

Bazuar në arsyetimet e sipërpërmendura është vendosur si në diapozitiv.

**MJETI JURIDIK:** Kundër këtij Aktgjykimi nuk lejohet ankesa.

**GJYKATA E QARKUT E GJILANIT  
AC. nr.158/2011, me 31.10.2011**

**KRYETARE E TRUPIT GJYKUES**



**ROSITZA BUZOVA**

Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik

**Përkthyer nga anglishtja ne shqip nga:**

**MEJREME YMERI, perkthyes ne EULEX,**

*Përgatitur në Gj. Angleze si gjuhë zyrtare, në përputhje me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.*

---

## NJOFTIM MBI KËSHILLIM DHE VOTIM

**GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT**, në kolegjin gjyqësor të përbërë nga Gjyqtarja Civile e EULEX-it ROSITZA BUZOVA, si kryetare e kolegjit, gjyqtari vendor MUHAMET REXHA dhe gjyqtari vendor ABDULLAH AHMETI, si anëtarë të kolegjit, **me 31 tetor 2011 diskutuan dhe votuan unanimitisht si në dispozitivin e këtij aktvendimi.**

Ky njoftim i bashkëngjitet Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të GJILANIT AC. nr.158/2011, të datës 31 tetor 2011 në pajtim me nenin 140 , paragrafi 1, fjalia e dytë e LPK-së.

### GJYKATA E QARKUT TË GJILANIT

AC.nr.158/2011 me 31.10.2011

---

**ROSITZA BUZOVA**

**Kryetare e trupit gjykues**

---

**MUHAMET REXHA**

**Anëtari i trupit gjykues**

---

**ABDULLAH AHMETI**

**Anëtari i trupit gjykues**

---

**ANDRES MORENO**

**Zyrtar ligjor i EULEX-it**

---

**XHANGYLE ILIJAZI**

**Përkthyes (Anglisht/shqip)**

**Përkthyer nga anglishtja ne shqip nga:**

**MEJREME YMERI, perkthyes ne EULEX,**

  
\_\_\_\_\_

*Përgatitur në Gj. Angleze si gjuhë zyrtare, në përputhje me Nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë dhe e nënshkruar nga gjyqtarët vendor pas përkthimit të bërë nga përkthyesja e cekur më lart.*